



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRI E ARSMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJE
REKTORATI		
Nr./Et./No. 251	Nr./faq./Dz./str./No./pg 1	
Data / Datum / Date 07/02/2023 Pejë / Peë		

Këshilli Drejtues



Datë: 06.02.2023

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 03.02.2023, morri këtë:

VENDIM

- I. MIRATOHET Rregullorja për Avokatin e studentëve, në "Universitetin Haxhi Zeka", në Pejë.
- II. Këtij vendimi i bashkangjitet Rregullorja për Avokatin e studentëve, në UHZ, në Pejë.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së
Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu



Vendimi t'i dërgohet: Kryesueses së KD-së, Anëtarëve të KD-së, Rektorit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivës së UHZ-së.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"**

**RREGULLORJA PËR AVOKATIN E STUDENTËVE NË UNIVERSITETIN
"HAXHI ZEQA" NË PEJË**

Pejë, Shkurt 2023

Në mbështetje të nenin 22 dhe 23 të Statutit nr. 04-V-662 të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, në mbledhjen e mbajtur me datë 03.02.2023, miraton këtë:

RREGULLORE PËR AVOKATIN E STUDENTËVE NË UNIVERSITETIN

"HAXHI ZEKA" NË PEJË

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i Zyrës së avokatit të studentëve të UHZ-së, është të sigurojë një burim të besueshëm të ndihmës joformale, të paanshme, të pavarur dhe deri në nivelin e lejuar me ligj, për studentët e UHZ -së. Avokati i studentëve ndihmon studentët duke dëgjuar shqetësimet, duke sqaruar çështjet, duke shpjeguar politikën, duke artikulluar opsionet, duke shërbyer si palë neutrale në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe duke ofruar drejtime për burime të tjera.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore përcakton mënyrën e funksionalizimit të Avokatit të studentëve, formën e organizimit dhe procedurat që duhet të ndiqen nga studentët për iniciimin dhe shqyrtimet e rasteve që bien në kompetencën e zyrës së Avokatit të Studentëve.
2. Kjo rregullore zbatohet nga i gjithë personeli dhe studentët e UHZ-së .

Neni 3

Parimet etike që drejtojnë Avokatin e Studentëve

1. **Pavarësia** - Zyra e Avokatit të Studentëve është e pavarur në shkallën më të lartë të mundshme brenda Universitetit.
2. **Neutraliteti dhe paanshmëria** - Avokati i studentëve, i caktuar si neutral, mbetet i paanshëm dhe nuk përfshihet në ndonjë situatë që mund të krijojë një konflikt interesi.
3. **Besueshmëria** - Avokati i studentëve i mban të gjitha komunikimet me ata që kërkojnë ndihmë në çështjen e ngritur në besueshmëri të lartë dhe nuk i zbulon komunikimet e besueshme, përveç nëse jepet leja për ta bërë këtë. Përjashtimet e vetme nga ky privilegj i besueshmërisë janë kur duket se ekziston një rrezik i pashmangshëm i dëmit serioz, ose nëse avokatit të studentëve i kërkohet ndryshe me akt të posaçëm që të zbulojë, raportojë ose dëshmojë.

4. **Jo formaliteti** - Avokati i studentëve, si një burim joformal, i reziston dëshimit në ndonjë procedurë formale, duke pohuar natyrën e besueshme të komunikimeve me Zyrën e Avokatit të studentëve.

Neni 4 Standardet e Punës

1. Avokati i studentëve do të funksionojë sipas kësaj rregullore.
2. Qasja në shërbimet e zyrës së Avokatit të studentëve të UHZ, është e mundur vetëm për studentët e UHZ -së.

Neni 5 Kualifikimet e Avokatit të studentëve

1. Kandidati/ja i/e cila propozohet nga Rektori për pozitën e avokatit të studentëve, është e dëshirueshme të ketë këto kritere:
 - 1.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Të ketë diplomë universitare;
 - 1.3. Të jetë person me reputacion të lartë publik, me aftësi përkatëse profesionale dhe me aftësi të tjera praktike;
2. Personi i përzgjedhur si avokat i studentëve duhet të ketë aftësi të mira komunikimi, të jetë i drejtë, diplomatik dhe të jetë i ndjeshëm ndaj çështjeve të diversitetit.

Neni 6 Detyrat dhe raportimi i avokatit të studentëve

1. Detyrat e avokatit të studentëve janë:
 - 1.1. Trajtimi i shqetësimeve të studentëve si pasojë e sjelljes së personelit të Universitetit, apo procedurave të Universitetit;
 - 1.2. Rekomandimi i procedurave për të ju përgjigjur nevojave të identifikuar.
2. Për të kryer këto detyra, avokati i studentëve do të ketë qasje në çdo informacion të përshtatshëm të UHZ, që ka të bëjë me studentët që nuk cenon të drejtat e një individi për privatësi.
3. Avokati i studentëve mbështetet në sqarim, gjetje të fakteve, bindje dhe pajtim për të zgjidhur shqetësimet dhe rekomandon procedurat që duhen ndjekur studentët. Avokati i studentëve nuk ndërmjetëson dhe nuk ka fuqi gjyqësore apo ndëshkuese.
4. Avokati i studentëve do të përgatisë një raport vjetor për KD – në, me qëllim të vlerësimit vjetor. Avokati i studentëve inkurajohet të bëjë rekomandime për të gjitha pjesët dhe nivelet e institucionit për përmirësimin e procedurave të UHZ, që kanë të bëjnë me studentët.

Neni 7

Emërimi dhe mandati i Avokatit të Studentëve

1. Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në bazë të propozimit të Rektorit bënë emërimin e kandidatit të propozuar për pozitën e Avokatit të studentëve.
2. Avokati i studentëve zgjedhet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Këshillit Drejtues për një mandat 4 vjeçar, me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat.

Neni 10

1. Zyra e Avokatit të studentëve të Universitetit ndodhet në selinë e Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë .
2. Avokati i studentëve ka në dispozicion zyren dhe paisjet e nevojshme për të kryer aktivitetet e tij/saj.

Neni 11

Hyje në fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga ana e Këshillit Drejtues të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së.
Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu

